



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**

**UDHËZIM PLOTËSUES**

**Nr. 7/3 Datë 10/07/2010**

**“PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT VENDOR”**

Në përputhje me nenin 27 të Ligjit Nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqiperise”, Ministri i Financave,

**U D H E Z O N:**

**Hyrje**

Kërkesat për PBA 2011-2013 duhet të përgatiten në zbatim të Udhëzimit Nr. 7/1 date 22.02.2010 “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor”, Udhëzimit Nr. 7 date 22.02.2010, “Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale” dhe të këtij Udhëzimi Plotësues.

**A. Tavanet për Përgatitjen e Buxhetit**

- Tavanet Përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2011-2013, të përgatitura në baze të rivlerësimit të kuadrit makroekonomik dhe fiskal 2011-2013 dhe të miratuar nga Këshilli i Njesisë së Qeverisjes Vendore do të merren në konsiderate për hartimin e buxhetit të vitit 2011.
- Në parashikimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore do të mbani parasysh legjislacionin aktual ne lidhje me taksat dhe tarifat vendore.
- Kërkesat për fonde buxhetore janë detyrimisht brenda këtyre tavanëve dhe të shoqëruara me një relacion shpjegues.
- Transferta e pakushtëzuar për vitin 2011, do te jete afërsisht 3 % me e madhe se transferata e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit i vitit 2010.
- Kriteret dhe koeficientet e formulës së shpërndarjes së transferues së pakushtëzuar për vitin 2011 do të jene ato të vitit 2010.

**B. Afatet për Përgatitjen e Buxhetit**

- Bazuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9936 date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqiperise”, përgatitja e kërkesave buxhetore për Fazën II te PBA 2011-2013, fillon me date 10.07.2010 dhe përfundon **ne datën 31 Gusht 2010**, për njësitë e qeverisjes qendrore. Afërsisht i njëjti kalendar ju rekomandohet që të aplikojne edhe njësitë e qeverisjes vendore. Formularët Nr. 1 dhe 2 sipas Udhëzimit Nr. 7/1 date 22.02.2010 “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor”, nëse kane ndryshime me ato të dërguara më pare pas miratimit nga këshilli të PBA-se, duhet të dërgohen në Ministrin e Financave brenda datës 15 Gusht.

### **C. Procedurat për Përgatitjen e Kërkesave Buxhetore**

- Procedurat për hartimin e kërkesave buxhetore janë të detajuara në Udhëzimin Nr. 7/1 date 22.02.2010 “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor” dhe anekset përkatëse sipas formateve standarde në Excel. Kërkesat për shpenzime kapitale plotësohen sipas procedurave të Menaxhimit të Investimeve Publike të Udhëzimit Nr. 7 date 22.02.2010, “Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale”.
- **Ne ndryshim nga Faza e I e PBA, gjate Fazës se II nuk do te përgatiten kërkesa shtese.** Kjo do te thotë se procedurat për hartimin e kërkesave shtese nuk janë të aplikueshme në Fazën e II te përgatitjes se PBA-se.

### **D. Dorëzimi i Raporteve te Kërkesave për Shpenzime te PBA 2011-2013**

- Formularët Nr. 1 dhe 2 te PBA-se të dërguara nga njësitë e qeverisjes vendore në Ministrinë e Financave, nëse pas miratimit te PBA-se nga këshilli kanë ndryshuar, ato duhet të ridërgohen edhe një here në Ministrinë e Financave të korrigjuara sipas vendimit të këshillit brenda datës 15 Gusht në rruge zyrtare dhe ne rruge elektronike.
- Njësitë e qeverisjes vendore qe nuk kane dërguar ne Ministrinë e Financave deri me date 1 Qershor 2010, Formularin Nr.1 “Parashikimi i të ardhurave për periudhën 2010-2012” dhe formularin Nr.2, “Parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2011-2013”, sipas udhëzimit te Ministrit te Financave Nr. 7/1, date 22.02.2010, duhet ti dërgojnë ato menjëherë ne rruge zyrtare dhe elektronike dhe ne rast te kundërt, personat përgjegjës do të ndëshkohen sipas nenit 71 te Ligjit Nr. 9936 i datës 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqiperise”
- Formularët e mësipërm (Formulari 1 dhe 2) dërgohen në Ministrinë e Financave zyrtarisht dhe në forme elektronike. Forma elektronike paraqitet me CD, flash ose në adresën: [fbrahimi@minfin.gov.al](mailto:fbrahimi@minfin.gov.al), [jmemaj@minfin.gov.al](mailto:jmemaj@minfin.gov.al).

### **E. Mbështetja Këshillimore për Ministrinë e Linjës dhe Institucionet Qendrore**

- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA 2011-2013, vë në dispozicion për çdo Njësi të Qeverisjes Vendore adresat e e-mail-it. [fbrahimi@minfin.gov.al](mailto:fbrahimi@minfin.gov.al), [jmemaj@minfin.gov.al](mailto:jmemaj@minfin.gov.al) dhe numrin e telefonit 04 226 96 50.

**Ridvan BODE**

---

**MINISTER**

Konceptoi: F.Brahimi, J.Memaj

Miratoi: M.Dhemb